

	<b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova – Republic of Kosovo</b>  <b>Komuna e Prishtinës</b> <b>Opština Priština –Municipality of Prishtina</b>	
---	--	---

<b>Datë/a:</b>	07.06.2019
<b>Për/ Za/ To:</b>	OE-ik "Ambienti"
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit - Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës 

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 06.06.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Ambienti", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemali, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frashri, Pjeter Bogdani, Shkolla e Gjelber dhe Mehmet Xhevori,, me Nr. të Prok: 616 19 011 211 nxjerr:

## V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik "Ambienti", të dt. 06.06.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemali, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frashri, Pjeter Bogdani, Shkolla e Gjelber dhe Mehmet Xhevori, me Nr. të Prok: 616 19 011 211, kundër njoftimit për kontratë, të datës 25.02.2019 të publikuar në web-faqe të KRPP-së dhe me pretekstin se AK-ja nuk i ka kthyer përgjegje në kërkesat për sqarim;
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që ta vazhdoj aktivitetin.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsy e t i m

Eshte konstatuar se pretendimet e OE-ik "Ambienti" janë të pa bazuara për arsyet në vijim:

- Pretendimi i parë është i pa bazuar për faktin se kemi te bejme me dy aktivitete te ndryshme dhe me vlera te parashikuara qe ndryshojne shume ndersa kerkesat ne te dy rastet jane ne harmoni me dispozitat e LPP-se;
  - Pretendimi tjetër lidhur me siperfaqen e shkollave eshte i pa bazuar pasi qe ne Aneksin 1 jane paraqitur siperfaqet per secilen shkolle;
  - Pretendimi lidhur me kerkesa kontradiktore poashtu eshte i pa qendrueshem pasi qe kemi te bejme me dy aktivitete, te cilet jane publikuar me ndryshime kohe dhe ne publikimin e fundit eshte perfshire ngritja prej 4% ne kuader te pages bruto;
  - Pretendimi vijues poashtu eshte i pa bazuar pasi qe tenderi per pastrim te objekteve komunale ka vlere te parashikuara me shume se pese here me te madhe dhe per kete edhe kerkesat e FDT-se jane me te medha qe d.t.th. ne harmoni me vleren e parashikuara;
  - Edhe pretendimi i katert ka sqarimin si ai paraparak;
  - Kerkesa per pagesat e punetoreve nuk mund te largohet pasi qe eshte obligim sipas dispozitave ligjore;
  - Edhe kerkesat per paisje jane bere ne baze te vlerave te paarshikuara dhe specifikeve te siperfaqeve per pastrim;
  - Pretendimi vijues eshte ploteisht i pa bazuar pasi qe te gjitha kerkesat jane ne harmoni me ligjin dhe eshte e drejte e AK-se qe ti paarqes ne masen qe e mendon se eshte ne interesin e te gjithë OE-ik dhe te AK-se e jo te favorizohen disa OE-ik me kriteret qe i rekomandoni ju; dhe
  - Pretendimi lidhur me paqartesite per pagat eshte i sqaruar tek sqarimi i trete. Per fund ju njoftojme se te gjitha pergjegjet kane qene dje te pergatitura, por nuk i kemi percjellur pasi qe ju keni dorezuar Kerkese per rishqyrim.
- Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.**

### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

